

13 anije peshkimi në Portin e Sarandës përfundojnë instalimin e sistemit Blu Box, duke ju bashkuar kështu pjesës tjetër të flotës së anijeve shqiptare të peshkimit që përdorin këtë teknologji moderne.



Bashkëbisedim me fermerët e zonës së Vorës

Ministria Ekonomi takoi së bashku me Elisa Spiropalin fermerët e Vorës, me të cilët u diskutua Skema e Mbështetjes me Naftë për Bujqësinë. Kjo mbështetje do t'i vijë në ndihmë rreth 4,000 fermerëve të kësaj zone.

65 anije peshkimi aplikojnë për fondet e projektit IPA

Është përmbyllur procesi i aplikimit për fondet e projektit IPA, të Bashkimit Evropian, i cili mbështet prej disa vitesh zhvillimin e sektorit të peshkimit në vendin tonë. Rreth 65 anije peshkimi nga 230 në total u bënë pjesë e procesit, ku 41 prej tyre janë në Durrës, 20 anije peshkimi në Vlorë dhe 4 në Shëngjin. Fituesit e projektit IPA do të mbështeten me fonde deri në masën 50 përqind për investime në bordin e anijeve të peshkimit, për ndërrimin e motorëve, blerjen e pajisjeve elektronike dhe të ndërtimit të frigoriferëve.

Vizitë në pikën e grumbullimit "Hatija Shpk", Rërëz (Berat)

Vizita në "Hatija Shpk", ishte një rast shumë i mirë për të parë nga afër transformimin e ndodhur në këtë pikë grumbullimi që ndodhet në Rërëz, Berat. Nëpërmjet Skemave Kombëtare të Mbështetjes që mundësohen nga qeveria shqiptare, një investim modern do të lehtësojë punën e rreth 3000 fermerëve të zonës. Këto të fundit do i grumbullojnë produktet e tyre në kushte optimale dhe sipas standardeve të kohës.



Ekonomi takon ambasadorin austriak në Tiranë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Milva Ekonomi zhvilloi një takim zyrtar me ambasadorin e Austrisë në Tiranë Christian Steiner. Në fokus të takimit ishte bashkëpunimi dypalësh që daton që prej vitit 2010, ku dy vendet firmosën memorandumën dhe bashkëpunimin në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm rural, industrisë përpunuese në sektorin ushqimor, sigurinë ushqimore, sektorin e shëndetit të kafshëve. Ministria Ekonomi është ndalur dhe tek projektet e reja që synohet të zbatohen me palën austriake në fushën e bujqësisë duke konsideruar të rëndësishme për palën shqiptare, shkëmbim eksperience dhe trajnime për forcimin e kapaciteteve të stafit teknik të përfshirë në negociatat me BE-në për sektorin e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore, vreshtarisë dhe verës në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore.



Ekonomi në konferencën shkencore

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Milva Ekonomi mori pjesë në Konferencën shkencore "Pandemia dhe rimëkëmbja-strategjitë e përballjes dhe pritshmëritë e zhvillimit", organizuar nga Universiteti i Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave. Ministria Ekonomi ndau me panelin eksperiencën e saj si drejtuese e grupit të punës për planin e përllogaritjes së dëmeve të tërmetit dhe hartimin e programit të Rindërtimit (PDNA). Ky proces kulmoi me konferencën e donatorëve, në 17 shkurt 2020 në Bruksel, ku Shqipëria pati një mbështetje jo vetëm nga BE dhe vendet anëtare të saj, por edhe nga shumë vende të tjera dhe organizata ndërkombëtare. Shqipëria arriti të angazhonte në këtë proces 1 miliardë e 150 milionë Euro. Ky sukses i padiskutueshëm, u arrit mbi të gjitha në sajë të lobimit personal nga ana e Kryeministrit Rama, i cili shfrytëzoi çdo mundësi dhe kanal komunikimi për të arritur mbështetjen e nevojshme.



Takim me ambasadorin holandeze

Ministria Ekonomi u takua sot me ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në vendin tonë znj. Guusje Korthals Altes. Në takimin zyrtar të zhvilluar në ambientet e MBZHR-së, ministria Ekonomi dhe ambasadorja holandeze znj. Guusje Korthals Altes diskutuan për mundësi të reja bashkëpunimi në të ardhmen. Ministria Ekonomi falenderoi ambasadorin znj. Guusje Korthals Altes për mbështetjen financiare të qeverisë holandeze në projektin "Mbështetje Për rimëkëmbjen pas tërmetit përmes fondeve të UN SDG ACCELERATION FUND (Fondi i Përsheptimit të Objektivave të Qëndrueshme)". Ministria Ekonomi vlerësoi të suksesshme bashkëpunimet në të shkuarën, mes MBZHR-së dhe Agjencisë së Zhvillimit Holandez (SNV), për ndryshimet që sollën në kulturën e fermës rurale.



Prezantohet projekti "GREAT"

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ishte e ftuar në nisjes e zbatimit të projektit "GREAT" që synon fuqizimin ekonomik të grave rurale në Shqipëri dhe që mbështetet nga UN Women, FAO dhe Bashkëpunimi Italian. Në aktivitetin ishin të pranishëm ambasadori Italian në Tiranë z. Fabio Buci, përfaqësuesi i UN Women z. Michele Ribotta dhe drejtuesi i zyrës së FAO në Shqipëri z. Arben Kipi. Në fjalën e saj, ministria Ekonomi e cilësoi projektin "GREAT" shumë të rëndësishëm për qeverinë shqiptare e cila në prioritetet e saj ka zvogëlimin e pabarazive gjinore, fuqizimin e grave dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Ekonomi tha se sipas statistikave, në vendin tonë vetëm 6% e fermave menaxhohen nga gratë dhe mundësitë e punësimit jashtë fermës janë shumë të pakta për gratë në zonat rurale në raport me burrat. Sipas ministres Milva Ekonomi, nisur nga ky fakt, në objektivat e qeverisë për këtë vit, është rritja e numrit të fermerëve që përfitojnë nga skema e masave të mbështetjes në bujqësi, sidomos atyre femra.



Vizitë në fermën blegtorale Bonum shpk

"Bonum" shpk është një sipërmarrje kurajoze në rrethinat e Tiranës, që po zhvillohet prej vitesh, falë edhe mbështetjes që ka marrë edhe nëpërmjet skemave kombëtare. Një fermë blegtorale me 400 krerë dhi franceze, të racave Alpine dhe Saana, e cila drejtohet nga Dervisi. Një i ri që me pasionin për punën, ka vendosur të kthehet nga jashtë, dhe me eksperiencën e akumuluar prej shkollës dhe punës atje, vendosi të punojë në një sektor krejt të ri për të. Historia e tij është një thirrje e hapur për rininë shqiptare, që të frymëzohet për t'u angazhuar edhe në një sektor sfidues si ky i blegtorisë, ku mundësitë për punësim sa vijë edhe shtohen.

